

Standardet Ndërkombëtare në mbrojtje të jetës tuaj.

Janar 2010

Standardet Ndërkombëtare të publikuara nga Organizata Ndërkombëtare e Standardizimit (ISO) për tema që lidhen që nga veshjet mbrojtëse dhe sigurinë e makinave tek shenjat e sigurisë dhe të rejtat e fundit të shkencës, mbështesin objektivat e sotëm e dhëna në Ditën Botërore për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, një iniciativë kjo e Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO).



Sipas statistikave të ILO, në çdo 15 sekonda vdes një punëtor nga aksidentet në punë ose sëmundjet profesionale apo që shkaktohen nga kushtet e papërshtatëshme të punës. Shumë nga këto lloj aksidentesh mund të parandalohen nëse zbatohen standardet ndërkombëtare të ISO, të cilat gjenden plotësisht në përputhje me origjinalin, si Standarde Shqiptare në Drejtorinë e Përgjithshme të Standardizimit (DPS).

Sekretari i Përgjithshëm i ISO ndër të tjera komentoi: "Deri tani portofoli i ISO është më shumë se 18 000 standarde, zbatimi i të cilave do të rriste sigurinë e jetës dhe të shëndetit në vendet e punës. Përveç mbrojtjes së jetës së punëtorëve ato japin udhëzime për punëtorët në procesin e marrjes së vendimeve për blerje si dhe për detajet teknike mbi të rejtat më të fundit të teknologjisë në zbatim të rregulloreve dhe legjislacionit. Për vetë origjinën që ato kanë, si Standarde Ndërkombëtare, ato ndihmojnë në harmonizimin e kërkesave ligjore mbi sigurinë dhe shëndetin në mbarë botën dhe për rrjedhojë kanë kontributin e tyre në lehtësimin e tregtisë ndërkombëtare."

Komiteti Teknik i ISO (ISO/TC 94) si edhe i DPS që merret me hartimin e standardeve në këtë fushë, i përbërë nga 28 vende anëtare (me të drejtë vote) dhe 35 si observer (pa të drejtë vote), ka publikuar 97 standarde, titujt e disa nga të cilat janë dhënë si vijon:

Siguria Personale – Pajisjet dhe veshjet mbrojtëse – zbatimi i të cilit siguron nivelin e duhur për mbrojtjen në punë dhe udhëzime për personat që merren me blerjet dhe hartuesit e legjislacionit.

Standardizimi i parimeve të përgjithshme për sigurinë e makinerive dhe përfshirja e terminologjisë dhe metodologjisë është aktiviteti kryesor i Komitetit Teknik të ISO, **ISO/TC 199, Siguria e Makinerive.**

Për hartimin e standardeve në fushën e sigurisë së makinerive punojnë sëbashku industria (prodhuesit dhe projektuesit), organizmat shtetërorë për sigurinë dhe shëndetin, bordet kombëtare për sigurinë dhe shëndetin në punë, autoritet publike, konfederatat e bashkimeve tregtare dhe shoqatat e punëtorëve. Gjithashtu, Organizata Botërore e Shëndetësisë (OOSH) dhe ILO kanë statusin e tyre në këtë komitet.

Komiteti ISO/TC 199 ka publikuar 35 standarde për përgatitjen e të cilave kanë marrë dhe kanë dhënë konsensusin dhe kontributin e tyre 27 vende anëtare dhe 23 vende në statusin e vëzhguesit.

Publiku në përgjithësi, punëtorët dhe mjedisi janë të ekspozuar ndaj substancave të rrezikshme në atmosferë kur ato shfaqen në mënyrë natyrale apo nga çlirimi i tyre si rezultat i proceseve të ndryshme industriale, produktet apo nga pajisjet shtëpiake. Prezenca e këtyre substancave në ajër, çlirimi i tyre në ajër dhe në mjediset e brendshme kërkon kufizimin dhe ndalimin e tyre. Hartimi i metodave të harmonizuara për matjen e koncentrimin të ndotjes së ajrit bëhet nga **ISO/TC 146, që trajton problemet e ilësisë së Ajrit dhe Atmosferën në vendet e punës.** Ky Komitet ka hartuar e publikuar 27 standarde për përgatitjen e të cilave kanë marrë dhe kanë dhënë konsensusin dhe kontributin e tyre 21 vende anëtare dhe 13 vende në statusin e vëzhguesit.

Gjithashtu, kemi Komitetin Teknik **ISO/TC 145 – Identifikimi i sigurisë, shenjave, formave, simboleve dhe ngjyrave.** Zbatimi i standardeve të simboleve grafike është I një rëndësie të madhe sepse japin në mënyrë të saktë dhe pavarësisht nga gjuha informacion mbi rreziqet dhe sigurinë në vendet e punës;

Komitetin Teknik **ISO/TC 43 - Akustika dhe Zhurmat** - që ka hartuar e publikuar 117 standarde, zbatimi i të cilave do të çonte në nivele më të ulëta të zhurmave në vendet e punës e për rrjedhojë në uljen e dëmtivmeve në dëgjim dhe mërzitjeve/acarimeve;

Komitetin Teknik **ISO/TC 108, - Monitorimi i kushteve të vibrimeve mekanike dhe gjendjeve të shokut** – numëron 26 standarde ndërkombëtare zbatimi i të cilave do të ndihmontë në uljen e efekteve të rrezikshme nga vibrimet tek punëtorët në vendet e punës. Këto standarde hanë gjithashtu të dobishme për projektimin dhe monitorimin e makinerive në vendin e punës.

Standarde të tjera të ISO që lidhen me sigurinë dhe shëndetin në punë japin zgjidhje për çështje të ndryshme si pajisjet për mbrojtjen nga zjarri, saldimet, traktorët dhe

makineritë që përdoren për bujqësinë dhe pyjet, kërkesat mbi kompetencën për inspektorët e vinçave, menaxhimin e rrishtit në mjediset e punës me temperature të ulëta dhe çështje të reja të tilla si riciklimi më i sigurtë i anijeve dhe prodhimi e trajtimi i nano-materialeve.

Këto standarde dhe të tjera që nuk janë përmendur në këtë artikull gjenden në Drejtorinë e Përgjithshme të Standardizimit (DPS). Ato kanë statusin e standardeve Shqiptare dhe janë adoptim i versionit original të standardeve ndërkombëtare të publikuara nga ISO.

Për më shumë informacion Ju lutemi të na kontaktoni:

Tel: +355 (0) 4 222 62 55

Fax: +355 (0) 4 224 71 77

E-mail: info@dps.gov.al

Gjithashtu mund të vizitoni faqen tonë të internetit:

Web: www.dps.gov.al – Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit